



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priniljeno/Prodato Received/Delivary	13.12.2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHCK	6063/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.926/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1425/2020 të datës të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.172/2020 të datës 23.06.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Kongresi i Blinajës", Nr.43, Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 10.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.172/2020 e datës 23.06.2020, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 03/02-127/20 i datës 06.04.2020, i Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 23.06.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1213/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 03/02-127/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, i pranuar nga ankuesi me datë 18.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 29.06.2020 ka

dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Policinë e Kosovës. Këshilli me datë 15.07.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.08.2020 përmes Njoftimit me numër protokoll 1449/2020, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.172/2020 të datës 23.06.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 15.10.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1425/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar njoftimin e datës 03.08.2020 të KPSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.172/2020 të datës 23.06.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.172/2020 e datës 23.06.2020, të parashtruar nga ankuesi Aktgjykimin A.nr.1425/2020 e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin e datës 03.12.2019, për Sistemim e përkohshëm të ankuesit; Ankesën e datës 23.12.2019, drejtuar Komisionit për Ankesa pranë Policisë së Kosovës; Vendimin me numër protokoll 03/02-32 të datës 28.01.2020 të Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës; e-mailin e datës 21.02.2020, i Drejtoreshës së Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës; Ankesën e datës 06.03.2020, drejtuar Komisionit për Ankesa tek Policia e Kosovës; Vendimin me numër protokoll 03/02-127/20 të datës 06.04.2020, të Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës; Kontratën e Punës së datës 01.08.2014, Përgjigjen në ankesës të datës 15.07.2020, me numër protokoll 1369/2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar Aktgjykimin A.nr. 1425/2020 të datës 15.10.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se është e pa bazuar ankesa e ankuesit *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Kontratës së Punës së datës 01.08.2014, ka ushtruar detyrën e punës "Shefi i Sektorit të Përkthyesve", në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, me koeficient tetë (8) të pagës e shprehur në vlerë prej 464,75 Euro, ndërsa me Vendimin me Nr.reference 07/1-01SAP-P/10544 të datës 03.12.2019, ankuesi është sistemuar përkohësisht në pozitën e punës "Shef i Sektorit të Përkthyesve", në Drejtorinë e Personelit, po me koeficient tetë (8) të pagës e shprehur në vlerë monetare 483.34 Euro. I pakënaqur me këtë vendim ankuesi me datë 23.12.2019 parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, më kërkesën që të anulohet Vendimi për sistemim të përkohshëm i datës 03.12.2019 ose i njëjti të rishqyrtohet ashtu që ankuesit ti aprovohet koeficienti i pagës në nivelin e udhëheqësit dhe ti kompensohet për tri vite diferenca e koeficientit në mënyrë retroaktive.

Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës, me Vendimin me numër protokoll 03/02-32 të datës 28.01.2020 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit dhe lëndën e ka rikthyer në rishqyrtim tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës.

Drejtorja e Personelit me datë 21.02.2020, ka njoftuar ankuesin se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovoj koeficientin e pagës të njëjtë me pozitë të njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civilë, duke shtuar

se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Ankuesi serish me datë 06.03.2020, parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, i cili me Vendimin me numër protokollit 03/02-127/20 i datës 06.04.2020 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë në KPMSHCK me pretendimet ankimore që vendimi i ankimuar është i padrejtë dhe në kundërshtim me vendimet e me hershme të këtij Komisioni i cili për të çështje të njëjta ka vendosur ndryshe duke ju referuar Vendimit me nr.418-Ka-2019 të datës 28.01.2020, kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Kolegji ka konstatuar se në kohën e nxjerrjes së Vendimit me nr. reference 07/1-01SAP-P/10544 të datës 03.12.2019 për transferimin e përkohshëm të ankuesit ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr.04/L-149 Për Shërbimin Civilë, e mbi këtë bazë ligjore janë shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit. Bazuar në dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil përkatësisht nën 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa nën 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës*, Kolegji ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Bazuar në këtë konstatim si dhe bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas kontratës së punës të datës 01.08.2014 si dhe Vendimit të datës 03.12.2019 për transferimin e përkohshëm, ka koeficient tetë (8) të pagës.

Po ashtu lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimit ankimor për harmonizim të koeficientit të pagës, Kolegji ju referua dispozitave ligjore të nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, e me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa.* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke marrë parasysh faktin së Policia e Kosovës ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për harmonizimin e koeficientit të pagës së ankuesit, por që një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër 03/02-127 /20, të datës 06.04.2020, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 926/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMIR

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Drejtorisë së Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

